



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 452
Lënda: Infermieri Patologjike

PROGRAMI I LËNDËS Infermieri Patologjike									
Titullari i lëndës:		Enkelejd Mëhilli <i>Dr. në Politika Shëndetësore</i>							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	12 ECTS	Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	12 ECTS	45	0	0	90	0	135	165	300
Tipologjia e lëndës		Lëndë karakterizuese B							
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II							
Lloji i lëndës		E detyruar							
Programi i studimit		Master Profesional ne Infermieri Patologjike.							
Kodi i lëndës		INF 452							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		mechili@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë modul studentëve u ofrohet mundësia për të rritur kapacitetet në fushën e kujdesit infermior për adultët. Integrimi i praktikimit të teknikave të reja infermiore, i zgjerimit të koncepteve për stadet e zhvillimit human, i pat-fiziologjisë, i menaxhimit mjekësor e infermior në planet e asistencës infermiore që kanë në qendër kujdesin për pacientin, u japin mundësi studentëve me formim infermior të përgjithshëm të masterizojnë kapacitetin e tyre profesional si infermierë patologë.</p>
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">☞ Njohja me diagnozat kryesore infermiore dhe planet e kujdesjeve në patologjitë e adultit.☞ Të vlerësohen njohuritë infermiore lidhur me teknikat më të avancuara.☞ Kujdesi infermior në patologjitë e ndryshme dhe përpilimi i rekomandimeve dhe edukimeve shëndetësore.
Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Të hartojë dhe zbatojë planet e personalizuara të asistencës infermiore në patologjitë kryesore, kardiologjike, pneumologjike, nefrologjike, reumatologjike, neurologjike, gastro-hepatologjike, hematologjike etj.☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit infermior të integruar të pacientëve adultë.☞ Të njohë dhe aplikojë teknikat infermiore më të avancuar atë kohës.☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit infermior në fushën e patologjive të adultit.☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

1. Infermiera patologjike e avancuar është lënda e cila trajton në mënyrë specifike hartimin e planeve infermirore në patologjitë kryesorë të sistemit kardiolgjik, gastrointestinal, hematologjik, neurologjik, reumatologjik dhe në shërbimin e Gëriartrisë dhe Gerontologjisë.
2. Infermieri arrin të përpilojë strategji të menaxhimit infermior të integruar të pacientëve me patologji të këtyre sistemeve.
3. Infermieri i kohëve moderne është ai i cili arrin të përpilojë një analizë kritike të kërkimit shkencor në fushën e patologjive të adultit.
4. Përpilimi i planeve të asistencës infermirore ndikon pozitivisht në përmirësimin e shërbimit infermior dhe i bën atë të pavarur në dhënien e rekomandime për ndryshime të caktuara.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Tema 1 – Procesi infermior. Planifikimi i Kujdesit infermior duke përdorur diagnozat infermirore. Vlerësimi, Diagnostikimi, Planifikimi-Implementimi, Kontrolli. <i>Guri i themelit të infermierisë klinike është procesi infermior, një metodë sistematike për të kryer veprime infermirore të pavarura.</i>	⁽¹⁾ fq.3-6	Leksion 1 orë
	Tema 2 - Kujdesi infermior në HTA, Kriza hipertensive <i>HTA është një nga sëmundjet më të përhapura në të gjithë botën. Në vendin tonë ai prek rreth 80% të popullatës së rritur.</i>	⁽¹⁾ fq.7-10	Leksion 1 orë
	Tema 3 . Kujdesi infermior në Infarkt akut të miokardit <i>IAM është një patologji që shprehet me zona të nekrotizuara në miokard, që vjen nga një spazëm e tejzgatur dhe nga obstrukcioni i arteries koronare në mungesë të qarkullimit kolateral dhe që çon në ndalimin e menjëhershëm të gjakut dhe oksigjenit në muskulin kardiak.</i> Praktikë infermirore në repartin e patologjisë	⁽¹⁾ fq11-13	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë
II.	Tema 4 – Kujdesi infermior në Angina pectoris <i>Angina Pectoris është një patologji që ndodh kur furnizimi me oksigjen në zemër nuk është i mjaftueshëm. Është një iskemi (anemi lokale) nga mospërputhja e nevojës së miokardit për oksigjen me furnizimin e tij nga arteriet koronare.</i>	⁽¹⁾ fq.14-17	Leksion 1
	Tema 5 . Kujdesi infermior në Insuficiencën kardiake. <i>Insuficienca kardiake është një gjendje kronike shumë e përhapur ku zemra e sëmurë ul aftësitë e një personi që të jetë mjaftueshëm aktiv nga ana fizike.</i>	⁽¹⁾ fq 18-21	Leksion 1 orë
	Tema 6 . Kujdesi infermior në Sëmundjet pulmonare obstruktive kronike, (SPOK) <i>SPOK është një sëmundje e karakterizuar nga kufizimi i rrjedhës së ajrit, e cila nuk është totalisht e rikthyeshme. Këtu përfshihen sëmundje që shkaktojnë obstrukcion (emfizemë, bronkit kronik) ose një kombinim të sëmundjeve.</i> Praktikë infermirore në repartin e patologjisë	⁽¹⁾ fq22-25	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
III.	<p>Tema 7. Kujdesi infermieror në Pneumoni <i>Pneumonia është proces inflamator i pulmoneve, i cili përqëndrohet në indin intersticial perialveolar dhe të mureve alveolare. Sëmundja prek çdo moshë, më tepër takohet në moshën 20-40 vjec.</i></p> <p>Tema 8. Kujdesi infermieror në Pneumotoraks dhe Hemotorax <i>Hapësira pleurale është një hapësirë virtuale, normalisht e padukshme dhe presioni në të është negativ. Prania e ajrit apo gjakut në këtë hapësirë shkakton gjendje të rëndë të pacientit, dhe nëse nuk traktohet në kohë mund të përparoj dhe të çojë në vdekje.</i></p> <p>Tema 9. Kujdesi infermieror në TBC <i>Tuberkulozi është një sëmundje ngjitëse, shkaktar i së cilës është bacili i tuberkulozit, i cili nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes hyn në organizëm.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë/infektiv</p>	<p>⁽¹⁾fq.26-29</p> <p>⁽¹⁾fq.30-33</p> <p>⁽¹⁾fq.34-37</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
IV.	<p>Tema 10. Kujdesi infermieror në Diabetin Mellitus <i>Diabeti Mellitus është një çrregullim kronik i metabolizmit të karbohidrateve, yndyrnave dhe proteinave. Ai paraqitet klinikisht si dëmtimi ose pakësimi i prodhimit të insulinës. Mungesa relative ose absolute e insulinës çon në uljen e përdorimit të glukozës nga qelizat, rrit metabolizmin e glikogjenit në glukozë, rrit katabolizimin e proteinave dhe lipideve me funksion glukogjenik.</i></p> <p>Tema 11. Kujdesi infermieror në Hypertireoza, tireotoxicosis dhe tiroidektomi. <i>Hyperthyroidizmi është termi për ind tepër aktiv në kuadër të gjendrës tiroide duke shkakuar një prodhim të tepërt të hormoneve tiroide (thyroxine dhe /ose trijodothyronine). Hyperthyroidizmi është kështu një shkak i thyrotoxicosis, gjendja klinike e rritjes së hormoneve tiroide në gjak.</i></p> <p>Tema 12. Kujdesi infermieror në Hypotiroidizëm <i>Hypothyroidizmi është sëmundje e shkakuar nga prodhimi i pamjaftueshëm i hormoneve tiroide nga gjëndra tiroide. Kretinismi është një formë e hypothyroidizmit e gjetur tek foshnjat.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë</p>	<p>⁽¹⁾fq.38-41</p> <p>⁽¹⁾fq.42-45</p> <p>⁽¹⁾fq.46-49</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
V.	<p>Tema 13. Kujdesi infermieror në pacientët me çrregullime të ushqyerjes, Anorexia nervore/ Bulimia nervore. <i>Anoreksia nervore është një çrregullim i të ushqyerit, që konsiston në rënie në peshë, frikë nga shtimi në peshë, dëshirë e madhe për të qëndruar e dobët apo kufizim të ngrënit. Ky problem vihet re më tepër tek gratë e reja dhe vajzat adoleshente se sa te meshkujt.</i> <i>Bulimia nervore është një çrregullim psikologjik i të ngrënit, që karakterizohet me intervale të të ngrënit të pakontrolluar, zakonisht me sasi të mëdha ushqimi, pasuar nga metoda joadekuate për të hequr qafe ushqimin e konsumuar (të vjella dhe marrje e laksativëve), në përpjekje për kontrollim të peshës.</i></p> <p>Tema 14. Kujdesi infermieror në pacientët me çrregullime të</p>	<p>⁽¹⁾fq.50-54</p>	<p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>ushqyerjes, Obeziteti. <i>Obeziteti është një nga sëmundjet më të përhapura dhe kronike që kanë nevojë për trajtim dhe parandalim mjekësor sistematik. Është e përcaktuar si një akumulim i tepërt i yndyrës në trup. Obeziteti është një gjendje klinike kronike që zakonisht kërkon terapi afatgjata për të nxitur dhe ruajtur humbjen e peshës.</i></p> <p>Tema 15. Kujdesi infermieror në kalkulozen renale dhe uretrale <i>Kalkuloza renale ose nefrolitjaza përfaqëson në vetvete prezencën e kristaleve ose të gurëve në veshka ose në rrugët urinare, që vijnë si pasojë e precipitimit ose agregimit të kripërave prezente në urinë në kushte normale ose patologjike.</i></p> <p>Praktikë infermirore në repartin e patologjisë</p>	<p>⁽¹⁾fq.55-58</p> <p>⁽¹⁾fq.59-63</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
VI.	<p>Tema 16. Kujdesi infermieror në hipertrofie beninje të prostatës, dhe në prostatektomi. <i>Problemet më të zakonshme të prostatës janë: Prostatitis (inflamacion akut ose kronik i prostatës), dhe hipertrofia beninje (zmadhim i prostatës). Termi më i zakonshëm është hiperplazia beninje e prostatës.</i></p> <p>Tema 17. Kujdesi infermieror në IRA <i>Insuficencia renale akute karakterizohet nga ndërprerja e papritur dhe e menjëhershme e funksioneve kryesore renale e shoqëruar me ndryshime metabolike që vijnë si rezultat i grumbullimit në organizëm të produkteve të katabolizmit proteinik.</i></p> <p>Tema 18. Kujdesi infermieror në IRK <i>IRK është një gjendje permanente, e parikthyeshme në të cilën veshka ndalon eliminimin e produkteve përfundimtare të metabolizmit dhe ujin e tepërt nga gjaku. Përbën stadin përfundimtar të zhvillimit të nefropative kronike dhe karakterizohet nga çrregullime të të gjitha funksioneve renale, me pasojë mbi ekuilibrin hidro-mineral, acido-bazik, fosfo-kalcik dhe tensioni arterial.</i></p> <p>Praktikë infermirore në repartin e patologjisë</p>	<p>⁽¹⁾fq.64-67</p> <p>⁽¹⁾fq.67-70</p> <p>⁽¹⁾fq.71-74</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
VII.	<p>Tema19. Hemodializa dhe dializa peritoneale <i>Dializa është një procedurë e cila kryhet tek pacientët veshka e të cilëve është përkohësisht ose përgjithmonë jashtë funksioni. Hemodializa kryhet duke lejuar gjakun të kalojë jashtë trupit nëpërmjet tubave të veçantë, pastrohet, dhe po kështu kthehet përsëri në trup nëpërmjet tubave të tjerë.</i></p> <p>Tema 20- Kujdesi infermieror në hepatite. <i>Planifikimi dhe menaxhimi i kujdesit infermieror për pacientët me hepatit përfshin: reduktimin e kërkesave të mëlçisë duke promovuar mirëqenien fizike, parandalimin e komplikacioneve të hepatitit, rritjen e vetë konceptit, pranimit dhe sigurimit të informacionit rreth procesit, prognozës dhe trajtimit të sëmundjes.</i></p> <p>Tema 21 - Kujdesi infermieror në cirozen hepatike.</p>	<p>⁽¹⁾fq.75-79</p> <p>⁽¹⁾fq.80-83</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Cirozis është një term i përgjithshëm, që përfshin të gjitha format e demtimeve kronike të përhapura të masës së heparit.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë</p>	⁽¹⁾ fq.84-87	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë
III.	<p>Tema 22- Kujdesi infermior në Kolecistite dhe në kalkulozën biliare. <i>Planifikimi dhe menaxhimi i kujdesit infermior për pacientët me cholecystitis dhe kalkulozë, përfshijnë lehtësimin e dhimbjeve dhe promovimin e pushimit, ruajtjen e balancës së lëngjeve dhe elektroliteve, parandalimin e komplikacioneve dhe sigurimin e informacionit rreth procesit, prognozës dhe trajtimit të sëmundjes.</i></p>	⁽¹⁾ fq.88-90	Leksion 1 orë
	<p>Tema23- Kujdesi infermior në kolecistektomi, menaxhimi i pacientëve me sëmundje biliare. <i>Cholecystectomy është heqja kirurgjike e fshikëzës së tëmthit. Kolecistektomia kryhet më shpesh përmes prerjeve laparoskopike duke përdorur lazer. Megjithatë, kolecistektomia tradicionale është trajtimi i zgjedhur për shumë pacientë me gurë të shumëfishtë të tëmthit (cholelithiasis) ose për shkak të simptomatologjisë akute ose për të parandaluar përsëritjen e gurëve.</i></p>	⁽¹⁾ fq91-93	Leksion 1 orë
	<p>Tema 24- Kujdesi infermior në pankreatite. <i>Pankreatiti akut është inflamacion i menjehershëm i pankreasit (parenkimes pankreatike) që pasohet nga lezionet duke filluar nga edema deri në nekroze indore koagulative. Pankreatiti kronik është sëmundje inflamatorë e pankreasit që karakterizohet nga demtime të parikthyeshme të indit pankreatik.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë</p>	⁽¹⁾ fq.94-97	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë
IX.	<p>Tema 25-Kujdesi infermior në peritonit. <i>Trajtimi i hershëm i inflamacionit gastrointestinal dhe terapisë preoperative ose postoperative mund të ndihmojë në parandalimin e peritonitit. Kujdesi për pacientin përfshin monitorimin dhe masat për të parandaluar komplikacionet dhe përhapjen e infeksionit.</i></p>	⁽¹⁾ fq.98-100	Leksion 1 orë
	<p>Tema 26 -Kujdesi infermior në Morbus Chron dhe në Kolutin Ulçeroz <i>Morbus Chron është një sëmundje inflamatorë kronike me ecure klinike perseritese recidivante që mund të interesojë cilendo zonë të traktit tretës prej gojës deri në anus.Inflamacioni përfshin të gjithë paretin e traktit të interesuar</i></p>	⁽¹⁾ fq.101-104	Leksion 1 orë
	<p>Tema 27. Kujdesi infermior në Anemi, anemia ferriprive, anemia pernicioze, anemia aplastike. <i>Anemia është çrregullimi hematologjik më i zakonshëm në të cilin niveli i hemoglobinës është më i ulët se normalisht , duke reflektuar praninë e një uljeje të numrit ose çrregullimeve në funksion të qelizave të kuqe të gjakut brenda qarkullimit.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë</p>	⁽¹⁾ fq.105-107	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë
X.	Tema 28 - Kujdesi infermior në Aneminë Drepanocitare.	⁽¹⁾ fq.108-112	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Planifikimi i kujdesit infermieror dhe qëllimet për pacientët me këtë patologji të përfshijnë: lehtësimin e dhimbjeve, uljen e incidencës së krizave hemolitike, ndjenjën e rritur të vetëvlerësimit dhe të fuqisë dhe mungesën e komplikacioneve.</i></p> <p>Tema 29-Kujdesi infermieror në Hemofili, Leuçemi <i>Hemofilia, një çrregullim i lidhur me kromozomin X është një trashëgimi e lindur hemoragjike, një çrregullim i mekanizmit të koagulimit i cili shkaktohet nga një gjen i dëmtuar që prodhon një proteinë të faktorit të koagulimit me defekte i cili ka pak ose aspak aftësi të koagulohet.</i></p> <p>Tema 30- Kujdesi infermieror në Alzheimer <i>Alzhaimeri është një lloj demence progresive që sjell ndryshime në personalitet në dy ose më shumë fusha të kuptuarit, zakonisht në memorie.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë</p>	<p>⁽¹⁾fq.113-17</p> <p>⁽¹⁾fq.118-120</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
XI.	<p>Tema 31-Kujdesi infermieror në Aksidentet Vaskulare Cerebrale (AVC). <i>Aksidenti cerebrovaskular, i njohur si goditje, infarkt cerebral, sulm në tru, është çdo anormalitet funksional ose strukturor i trurit, i shkaktuar nga gjendja patologjike e enëve cerebrale të të gjithë sistemit cerebrovascular.</i></p> <p>Tema 32.Kujdesi infermieror në Sklerozën Multiple <i>Skleroza Multiple është menduar të jetë një sëmundje autoimune, në të cilën sistemi i mbrojtjes i trupit sulmon dhe dëmton myelinin, shtresën izoluese që rrethon dhe mbron nervat trurin dhe palcën kurrizore.</i></p> <p>Tema 33.Kujdesi infermieror në epilepsi. <i>Epilepsia është një sëmundje e trurit, ku ka një përcjellje të shkurtër jo normale të impulseve elektrike që udhëtojnë midis qelizave të trurit.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë/ Spitali Psikiatrik</p>	<p>⁽¹⁾fq.121-125</p> <p>⁽¹⁾fq.126-130</p> <p>⁽¹⁾fq.130-134</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
XII.	<p>Tema 34, 35- Kujdesi infermieror në pacientët me CA. <i>Kanceri është një term i përgjithshëm i përdorur për të përshkruar një shqetësim të madh dhe i referohet një grupi sëmundjesh dhe. Për shkak se kanceri është një sëmundje qelizore, ajo mund të lindë nga çdo ind i trupit, me manifestime masive. Infermieret kanë përgjegjësi për trajtimin e një pacienti me kancer. Kujdesi infermieror përfshin vlerësimin, mbështetjen për terapitë (p.sh., kimioterapinë, rrezatimin etj.), kontrollin e dhimbjes, promovimin e të ushqyerit dhe mbështetjen emocionale.</i></p> <p>Tema 36- Kujdesi infermieror për pacientët në fazat terminale të jetës së tyre. <i>Vdekja është një tranzicion i thellë për individin. Si ofruet të kujdesit shëndetësor, ne duhet të bëhemi të aftë për të përballuar këto situata. Disa aspekte të këtij kujdesi po marrin më shumë rëndësi për pacientët, familjet dhe ofruet e kujdesit shëndetësor.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë</p>	<p>⁽¹⁾fq.135-143</p> <p>⁽¹⁾fq.144-149</p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
III.	<p>Tema 37 - Kujdesi infermieror në transplante, kujdesi postoperator dhe përgjatë gjithë jetës. <i>Kryerja e procedurës së transplantëve është mjaft e rëndësishme dhe e komplikuar dhe kërkon kujdes maksimal nga ana e personelit shëndetësor. Por ky kujdes përveçse pas ndërhyrjes, vazhdon gjatë gjithë jetës së pacientit nga ana e infermierit.</i></p>	⁽¹⁾ fq.150-159	Leksion 2 orë
	<p>Tema 38, 39 –Kujdesi infermieror në pacientët me SIDA, dhe parandalimi i saj <i>Sindroma e imunodeficiencës së fituar (AIDS) është një çrregullim serioz i mungesës së imunitetit të shkaktuar nga retrovirusi, human immunodeficiency virus (HIV).</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin infektiv</p>	⁽¹⁾ fq.160-163	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë
IV.	<p>Tema 40- Asistenca infermiere tek te moshuarit, problematikat më të rëndësishme, parimet themelore të asistencës infermiere tek të moshuarit. <i>Geriatra është shkenca mjekësore, që merret me mjekimin e sëmundjeve të plakjes.</i></p>	⁽²⁾ fq.164-166	Leksion 1 orë
	<p>Tema 41- Kujdesi infermieror dhe menaxhimi në sëmundjet kryesore që prekin moshat e treta. <i>Ka shumë rëndësi që në këtë përkufizim të dallojme “procesin normal të plakjes” dhe kufirin midis “shëndetit të mirë” dhe sëmundjeve të të moshuarit, gjë që përbën lidhjen me gerontologjinë</i></p>	⁽²⁾ fq.167-170	Leksion 1 orë
	<p>Tema 42. Rehabilitimi i pacientëve të cilët kanë abuzuar më përdorimin e substancave të ndryshme. <i>Përdorimi i alkoolit, duhanit dhe drogave të tjera përbën një rrezik të madh për shoqërinë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), përdorimi i alkoolit dhe duhanit renditet midis 10 faktorëve kryesorë të rrezikut për shëndetin në të gjithë botën, ndërsa përdorimi i drogave të paligjshme renditet ndër 10 faktorët kryesorë të rrezikut për shëndetin në vendet e zhvilluara.</i></p> <p>Praktikë infermiere në repartin e patologjisë/Spitali Psikiatrik</p>	⁽¹⁾ fq. 170-175	Leksion 1 orë Praktikë 6 orë
KV.	<p>Tema 43, 44. Kujdesi infermieror në familje dhe komunitet . <i>Roli i infermierit në dhënien e kujdesheve infermiere në familje është i pazëvendësueshëm.</i> <i>Niveli i kujdesit dhe nevojave të pacientit janë shpesh faktorët vendimtarë në përzgjedhjen e ndërhyrjes.</i> <i>Këto mund të jenë rehabilitimi afatshkurtër, Kujdesi infermieror afatgjatë -individët që kërkojnë ndihmë aktive të përditshme (ADL), Individët e moshuar të cilët janë popullata kryesore që kërkon ndihmë etj.</i></p>	⁽¹⁾ fq. 176-184	Leksion 2 orë
	<p>Tema 45. Kujdesi infermieror tek pacientët gjatë abstinenës nga alkoli Alkoolizmi, i njohur edhe si vartësia nga alkooli, është një sëmundje e cila përfshin katër simptomat e mëposhtme: “Dëshirë e papërmbajtur për të pirë. Humbje e kontrollit, pra të mos jesh në gjendje të ndalosh të pirën nëse ke filluar. Vartësi fizike. Simptomat e tërheqjes prej tij si ndjenja e të vjellës, djersitje, dridhje, ankth pas ndalimit të të pirës.</p>	⁽¹⁾ fq. 185-190	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	Toleranca, nevoja për të pirë sasira gjithnjë e më të mëdha alkooli për të ardhur në "qejt". Çfarë ndosh me pacientin gjatë fazës së abstinencës? Praktikë infermierore në repartin e patologjisë/Spitali Psikiatrik		Praktikë 6 orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhe dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.					
KONTROLI I VAZHDUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Temat 1-45	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportim rasti / Demonstrim procedure
	*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një projekti klinik që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të patologjive pediatrike apo neonatale, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. Gjithashtu do të realizojnë dhe 3 plane kujdesi, bazuar në një format të gatshëm, për asistencën shëndetsore të hasur në praktikë. Një pjesë e punimeve do të prezantohen dhe në PPT.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA

Literatura bazë e detyruar	(1) Cikël leksionesh, të përkthyer nga Evis Alushi, bazuar në: <i>Nursing Care Plans: Guidelines for Individualizing Client Care Across the Life Span</i> , 8th Edition (Marilynn E. Doenges, Mary Frances, R. N. Moorhouse, Alice C., R. N. Murr) Copyright © 2010 by F. A. Davis Company ISBN-13: 978-0-8036-2210-4 <i>Gerontological Nursing: Competencies for Care</i> By Kristen L. Mauk - Jones and Bartlett Publishers (2010) - ISBN 076375580X
-----------------------------------	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Literatura e rekomanduar	<ol style="list-style-type: none">1. <i>Fundamentals of Nursing: The Art and Science of Nursing Care</i> By Carol R. Taylor, Carol Lillis, Priscilla LeMone, Pamela Lynn - Lippincott Williams & Wilkins (2010) - ISBN 07817938312. <i>Critical care nursing: diagnosis and management</i> By Linda Diann Urden, Kathleen M. Stacy, Mary E. Lough - Mosby/Elsevier (2010) -ISBN 03230574893. <i>Nursing Diagnosis Manual: Planning, Individualizing, and Documenting ClientCare</i> By Marilyn E. Doenges, Mary Frances Moorhouse, Alice C. Murr - F.A. Davis Co. (2009) - ISBN 080362221X4. Protokollat e Kujdesjeve Infermiere Ne Sherbimin Spitalor, Dokument Themeltar Ii, Tirane 2006 ISBN 99943-785-2-x5. Paketa Bazë e Shërbimeve Në Kujdesin Shëndetësor Parësor ,Ministria e Shëndetësisë
---------------------------------	--

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse përsonat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.